**Mënyra e marrjes së kampionit të KËLBAZËS për ANALIZËN E KULTURËS**

- Përdorni për marrjen një enë sterile me grykë të gjerë dhe mbyllje me rrotullim që mund të blihet në farmaci ose të merret në laborator.

- Në mëngjes hiqni protezat eventuale të lëvizshme të dhëmbëve dhe bëni pastrimin e gojës me tretje fiziologjike ose ujë të distiluar ose me gargarë.

- Nxirreni këlbazën në enën sterile me anë të një kolle të efektshme dhe mblidhni të paktën 2 ml sekretim nga rrugët e poshtme të frymëmarrjes. Mos fusni pështymë ose sekrecione hundore (në kësi rastesh kampioni nuk konsiderohet i vlefshëm).

- Rividhosni me kujdes kapakun.

- Dorëzojeni menjëherë në laborator (brenda një ore) ose ruajeni në frigorifer në +4° C jo më shumë se dy orë (disa lloje mikrobesh nuk mbijetojnë për më shumë se dy orë nga marrja dhe disa të tjera mund të shumëzohen në kurriz të të tjerave duke e ndryshuar raportin e natyrshëm sasior të përbërësve të ndryshme mikrobike të materialit, duke çuar në vlerësime të gabuara).

- Në rast se kërkohet mbledhja në disa ditë të njëpasnjëshme, secili kampion duhet marrë dhe dorëzuar çdo ditë brenda një ore.